



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 100 prot.

Kamëz, më 4.8.2021

V E N D I M

Nr. 82.Datë 4 / 8 2021
PËR

**MBËSHTETJEN FINANCIARE TË ATLETËVE QË DO TË PËRFAQËSOJNË
BASHKINË KAMËZ NË KAMPIONATIN BALLKANIK TË ATLETËVE MASTËR,
17 – 19 SHTATOR, KORÇË 2021**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 4.08.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt –Vendim Nr.71 Datë 3.08.2021** në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, shkronja “b”, nenit 25, pika 4, nenit 55, pikat 2 dhe 6, Kretut VII, neni 25, pika 4 të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 7, pika 2 të Ligjit Nr.79/2017 “Për Sportin”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, shkresës nr.187/1, date 27.05.2021 të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore pranë Ministrisë së Brendëshme; Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I :

**MBËSHTETJEN FINANCIARE TË ATLETËVE QË DO TË PËRFAQËSOJNË
BASHKINË KAMËZ NË KAMPIONATIN BALLKANIK TË ATLETËVE MASTËR,
17 – 19 SHTATOR, KORÇË 2021;**

1. Mbështetjen financiare të 6 atletëve që do të përfaqësojnë Bashkinë Kamëz në Kampionatin Ballkanik të Atletëve Mastër, 17 – 19 shtator, Korçë 2021 nga buxheti i Bashkisë Kamëz.
2. Mbështetja financiare për aktivitetin e sipërcituar do të jetë në masën 108.000 (njëqind e tetë mijë) lekë.
3. Fondet për përballimin e kësaj shume do përdoren nga plani i buxhetit të vitit 2021 për sportin, Struktura Buxhetore Prog. 8130 kap.5 Art. 604.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Nën/ Kryetar Këshilli
Jamdiella ÇIPA